

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6299  
E shtunë, 24 prill 2021  
çmimi 0.40 €

## Sfidat e ndërmjetësimit në Kosovë



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NDËRKOMBËTARËT TË GATSHËM PËR FILLIMIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

# SHTOHET PRESIONI NDËRKOMBËTAR PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

Ndonëse Qeveria e Kosovës ende nuk ka bërë të qartë se cila do të jetë qasja ndaj dialogut me Serbinë, ndërkombëtarët kanë shtuar presionin për këtë proces. Në letrat e urimit për konstituimin e institucioneve të reja, presidentët dhe kryeministrat e vendeve më të fuqishme perëndimore kanë inkurajuar Kosovën për vazhdimin e këtij procesi drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjërisht të detyrueshme. Në letrat e tyre, ata kanë përmendur kompromiset e vështira në proces dhe njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë



## KOSOVA DHE MAQEDONIA SYNOJNË THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT NË EKONOMI DHE TURIZËM



Ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka zhvilluar të premtan takime në Prishtinë me zyrtarë të institucioneve të Kosovës. Osmani në këto takime është marrë vesh që bashkëpunimi në ekonomi dhe turizëm të thellohet edhe më tej në mes të Kosovës dhe Maqedonisë

## DO TË ORGANIZOHET MËSIMI ALTERNATIV I PËRSHPEJTUAR PËR 441 NXËNËS TË KAMENICËS



### AKTUALE



BE-ja SIGURON VAKSINA PËR 70 PËR QIND TË TË RRITURVE DERI NË KORRIK

POLICIA SHTON KONTROLLET PËR ZBATIM TË MASAVE KUNDËR COVIDIT

BAHTIRI DHE DURMISHI SHIKOJNË NGA AFËR PROJEKTIN E SHTRATIT TË LUMIT IBËR

### EKONOMI



ANP "ADEM JASHARI" THYEN REKORD ME NUMRIN E PASAGJERËVE

SHEFI I BE-SË: VENDIM I DUHUR PUBLIKIMI I LISTËS SË BIZNESEVE QË PËRFITUAN MË SË SHUMTI



### SPORT

KOSOVA ZHVILLON DY MIQËSORE NË QERSHOR

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## BE-ja siguron vakcina për 70 për qind të të rriturve deri në korrik

**BRUKSEL, 23 PRILL** - Bashkimi Evropian do të sigurojë doza të mjaftueshme për të imunizuar 70 për qind të të rriturve deri në fund të korrikut, tha të premten shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Më herët ajo kishte përmendur fundin e muajit shtator, por gjatë një vizite në një fabrikë belge për prodhimin e vaksinave, ajo e ndryshoi afatin. "Unë besoj se deri në korrik do të kemi doza të mjaftueshme për të vaksinuar 70 për qind të të gjithë të rriturve në BE", ka thënë von der Leyen në një fabrikë që prodhon

"Pfizer/BioNTech".

Ajo paralajmëroi se në ditët e ardhshme blloku evropian do të arrijë një kontratë të re me kompaninë "Pfizer/BioNTech" për sigurimin e një shtese prej 1.8 miliard dozave të vaksinës gjatë vitit 2020 dhe 2023. Vakcina "Pfizer", e zhvilluar me partnerin gjerman "BioNTech", është e shtrenjtë në krahasim me disa konkurrentë dhe përdor teknikën RNA që mund të përshtatet me variantet e ardhshme të koronavirusit. Komisioni Evropian kishte një fillim të vështirë për realizimin e planit për blerjen e përbashkët

të vaksinave për 27 vendet anëtare. Procesi u ballafaqua me mungesa në furnizim, veçanërisht me vaksinën "AstraZeneca" të Mbretërisë së Bashkuar.

Por, Ursula von der Leyen falënderoi "Pfizer" dhe nënkontraktorin e saj për "përpjekjen e madhe" për ofrimin e mundësive të furnizimit.

Komisioni Evropian po harton plane për të ndërmarrë veprime ligjore kundër "AstraZenecas", për dështimin e saj në përmbushjen e objektivave të shpërndarjes së vaksinave.



## Navalny i jep fund grevës së urisë



**MOSKË, 23 PRILL** - Lideri i opozitës ruse, Aleksei Navalny, ka njoftuar se do ta përfundojë grevën e urisë. Përmes një postimi në "Instagram", Navalny tha se shëndeti i tij është i përqësuar dhe se po vazhdon të kërkojë që ai të kontrollohet nga mjekët e tij personal.

Më 22 prill mjekët i thanë atij se duhet ta përfundojë grevën e urisë dhe se, nëse ajo

vazhdon edhe pak, "nuk do të kenë më një pacient për të trajtuar".

Navalny, 44 vjeç, ka thënë se do të duhen 24 ditë për t'u kthyer gradualisht në një rutinë normale të ngrënies. Ai e filloi grevën e urisë më 31 mars duke kërkuar trajtim shëndetësor nga mjekët jashtë burgut.

Mjeku personal i Navalnyt, kreu i Sindikatës i Aleancës së Mjekëve të Rusisë dhe tre

mjekë të tjerë, përfshirë një kardiolog, thanë në një letër për Shërbimin Penal Federal të Rusisë, se gjendja e tij ishte përqësuar me shpejtësi dhe se ai mund të pësonte infarkt "në çdo minutë".

Vendimi për ta ndërprerë grevën e urisë vjen dy ditë pasi mijëra rusë anembanë Rusisë iu bashkuan protestave duke kërkuar që Navalny ta marrë trajtimin e duhur mjekësor.

## Mbi 100 persona të plagosur nga përleshjet në Jerusalemin Lindor

**JERUSALEM, 23 PRILL** - Një numër personash janë plagosur në përleshjet në Jerusalemin Lindor në mes të aktivistëve hebrej të linjës së djathtë, palestinezëve dhe policisë izraelite. Dhuna ka shpërthyer teksa policia ka tentuar të krijojë distancë në mes të palestinezëve dhe protestuesve hebrej. Gjysmëhëna e Kuqe në territoret

palestineze ka thënë se të paktën 100 palestinezë janë plagosur, derisa policia ka thënë se 20 zyrtarë janë plagosur. Më shumë se 50 persona është raportuar të jenë arrestuar. Këto raportime për përleshje vijnë në kohën e rritjes së tensioneve në mes të grupeve nacionaliste dhe atyre fetare. Jerusalemi Lindor është prej kohësh pikë e ndjeshme për

shkak të bashkëjetesës jo të lehtë në mes të hebrejve dhe arabëve.

Izraeli ka pushtuar Jerusalemin Lindor nga viti 1967 dhe e konsideron gjithë qytetin si kryeqytet të vetin.

Palestinezët pretendojmë se Jerusalemi Lindor do të jetë kryeqytet i shtetit, të cilin shpresojnë ta kenë në të ardhmen.



## Nis vaksinimi i deputetëve në Maqedoninë e Veriut

**SHKUP, 23 PRILL** - Në Maqedoninë e Veriut të premten ka nisur vaksinimi i deputetëve kundër Covid-19. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, ka bërë me dije se deputetët do të vaksinohen me vaksinën ruse Sputnik V.

Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, ka thënë se u ka dorëzuar institucioneve shëndetësore listën me të gjithë 120 deputetët të cilët janë njoftuar për vendin dhe

kohën e vaksinimit dhe se u takon atyre të vendosin nëse do t'i përgjigjen ose jo thirrjes. "Të gjithë ata kanë të drejtë të vendosin nëse duan ose jo të vaksinohen. Atyre u është ofruar mundësia e vaksinimit dhe u takon vetë atyre të vendosin nëse duan ose jo të bëjnë këtë", ka deklaruar Xhaferi.

Kryeparlamentari Xhaferi tha se shpreson që ky proces do të mundësojë punë më të efikase të Kuvendit dhe se

nga gjysma e dytë e majit, puna t'i kthehet normalitetit. Të hënën Maqedonia e Veriut siguroi 10 600 vakcina "Pfizer", ndërsa deri në fund të muajit pret edhe 10 mijë të tjera sikur edhe 200 mijë vakcina kineze "Sinofarm". Për lehtësimin e masave do të vendoset në fillim të javës së ardhshme.

Qeveria ka paralajmëruar hapjen e sektorit të gastronomisë si dhe shkurtimin e orës policore.





# Kosova dhe Maqedonia synojnë thellimin e bashkëpunimit në ekonomi dhe turizëm

Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka zhvilluar të premten takime në Prishtinë me zyrtarë të institucioneve të Kosovës. Osmani në këto takime është marrë vesh që bashkëpunimi në ekonomi dhe turizëm të thellohet edhe më tej në mes të Kosovës dhe Maqedonisë



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 PRILL - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka vizituar të premten Kosovën. Gjatë vizitës së tij Osmani është takuar me përfaqësues të institucioneve të Kosovës. Osmani është pritur në takim nga presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ku është theksuar se marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve janë vlerësuar të shkëlqyeshme. Të dyja palët kanë shprehur gatishmërinë që të thellohen edhe më tej, posaçërisht në sferën e ekonomisë dhe turizmit. Ministri Osmani ka theksuar se Maqedonia e Veriut do të qëndrojë krah Kosovës në rrugën e saj evropiane, duke shprehur mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe në BE. Në këtë kontekst, ai ka kundërshtuar idetë për rivizatimin e kufijve, duke theksuar se Marrëveshja e Ohrit, pavarësia e Kosovës dhe perspektiva euroatlantike e rajonit janë treguar modele të suksesshme. Presidentja Osmani ka ritheksuar se skenarë të tillë duhet të parandalohen bashkërisht. "Nuk pranojmë ide

që prekin kufijtë tanë dhe e bëjnë Kosovën jofunkionale", ka theksuar Osmani.

Në takim, ndër të tjera, është biseduar edhe për situatën e pandemisë Covid-19 në të dy shtetet. Presidentja Osmani ka thënë se në bashkërendim me Qeverinë po e bëjnë të pamundshmen që bashkë me partnerët ndërkombëtarë t'i sigurojnë vaksinat për qytetarët e Kosovës.

## Kurti dhe Osmani diskutuan për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me zëvendësministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, kanë pritur të premten në takim ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani.

Ky i fundit ka uruar kryeministrin Kurti për fitoren në zgjedhjet e 14 shkurtit dhe për procesin zgjedhor demokratik dhe institucionet e reja të dala nga ky proces. Ai ka theksuar se kjo ishte vizita e tij e

parë zyrtare në Kosovë që kur është zgjedhur ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 30 gusht 2020. Gjatë takimit u vlerësuan marrëdhëniet në mes të Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut si model i fqinjësisë së mirë.

Kurti dhe Osmani biseduan për veprime konkrete dhe koordinim më të mirë mes dy qeverive për ta lehtësuar transportin rrugor dhe qarkullimin e mallrave. Po ashtu, u morën vesh lidhur me hapat e mëtejshëm rreth organizimit të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, ku do të nënshkruhen një sërë marrëveshjesh mes të dy shteteve. Ministri Osmani u shpreh i lumtur për konfirmimin e pjesëmarrjes së kryeministrin Kurti në Samitin e Prespës, që planifikohet të mbahet në korrik të këtij viti.

Temë e takimit ishte edhe çështja e integritetit evropian, ku kryediplomati konfirmoi mbështetjen e vazhdueshme të Maqedonisë së Veriut për Kosovën në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

## Vazhdojnë punimet në projektin e autostradës Shkup-Ohër-Strugë-Qafë Thanë

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur të premten në takim

bilateral në Prishtinë ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, me të cilin kanë zhvilluar edhe konferencë të përbashkët për media.

Ministrja Gërvalla ka falënderuar Osmanin për vizitën e tij në Kosovë dhe bashkërisht kanë vlerësuar se Republika e Kosovës dhe e Maqedonisë së Veriut janë dy shtete fqinje shembull për fqinjësi, bashkëpunim dhe partneritet të mirë.

Në të njëjtën kohë, raportet mes të dy vendeve në nivel të marrëveshjeve bilaterale i kanë vlerësuar të shkëlqyera dhe kanë diskutuar konkretisht për thellim të tyre.

Palët kanë shkëmbyer përvojat lidhur me çështjen e pandemisë Covid-19 dhe mënyrën e menaxhimit të situatës.

Në takim është shprehur përkushtimi i të dyja palëve që të

shtyhen përpara planet dhe marrëveshjet e përbashkëta dhe të iniciohen hapa konkretë në drejtim të bashkëpunimit tregtar, në sektorin e energjisë si dhe në krijimin e një pakoje turistike të përbashkët.

Po ashtu u theksua nevoja e krijimit të pikave të përbashkëta të kontroleve në vendkalime kufitare sipas konceptit 'One Stop Shop'.

Ministri Osmani ka treguar se janë duke përmbyllur autostradën Shkup-Bllacë përdërisa po punohet në projektin strategjik për finalizim të "Korridorit 8" apo autostradës Shkup-Ohër-Strugë-Qafë Thanë. Gjithashtu ministri Osmani ka shprehur përkushtimin e shtetit të tij ta mbështesë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së, në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si dhe në shkëmbim të përvojave për anëtarësim në NATO.



## Sibel Halimi emërohet zëdhënëse e LDK-së

Prishtinë, 23 prill (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka emëruar Sibel Halimin, zëdhënëse politike e LDK-së. Lajmi është bërë me dije nga LDK-ja. "Sibeli, përveçse është anëtare e Kryesisë e

Lidhjes Demokratike të Kosovës, është edhe sociologe e poete. Ajo është doktorante në Departamentin e Sociologjisë të Universitetit të Prishtinës. Deri tash ka botuar tre libra me poezi: 'Kopshti i mëkateve' (2002),

'Qenia nuk banon këtu' (2013), 'Me ekzistues është vetë kuptimi' si dhe përmbledhjen eseistike 'Shoqëri në alarm' (2017). Merret aktivisht me trajtimin e problemeve socio-filozofike, ndërkohë që shkrimet e saj janë botuar në

periodikun shqip dhe të huaj. Njihet si veprimtare e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë për të drejtat e grave dhe vajzave. Lidhja Demokratike e Kosovës pret dhe fton për një bashkëpunim të nevojshëm me mediat dhe me



publikun", është thënë në njoftimin e LDK-së.





NDËRKOMBËTARËT TË GATSHËM PËR FILLIMIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

# Shtohet presioni ndërkombëtar për vazhdimin e dialogut

Ndonëse Qeveria e Kosovës ende nuk ka bërë të qartë se cila do të jetë qasja ndaj dialogut me Serbinë, ndërkombëtarët kanë shtuar presionin për këtë proces. Në letrat e urimit për konstituimin e institucioneve të reja, presidentët dhe kryeministrat e vendeve më të fuqishme perëndimore kanë inkurajuar Kosovën për vazhdimin e këtij procesi drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjërish të detyrueshme. Në letrat e tyre, ata kanë përmendur kompromiset e vështira në proces dhe njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë

juaj në çdo hap”, ka thënë presidenti amerikan Joe Biden në letrën e urimit për zgjedhjen e Vjosa Osmanit presidente.

Ai ka bërë me dije se marrëveshja gjithëpërfshirëse për normalizim duhet të përqendrohet në njohjen reciproke. Edhe presidenti francez Emmanuel Macron në letrën e urimit drejtuar presidentes Osmani ka përmendur çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë letër, ai ka inkurajuar Kosovën për vazhdimin e këtij procesi drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjërish të detyrueshme.

I fundit që ka inkurajuar Kosovën për vazhdimin e këtij procesi ka qenë ministri i

Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Heiko Maas.

Gjatë vizitës në Kosovë, të enjten Maas ka thënë se Gjermania ka ofruar vazhdimisht mbështetjen e pakusht për dialogun në mes të këtyre vendeve, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. “Natyrishë që njohja e Kosovës do të jetë një nga elementet e zgjidhjes, përndryshe s’do të realizohet. Është normale që në dialogët për normalizim duhet të ketë dhe ka kompromise. S’dua të tërheq linja të kuqe, por e di që edhe nga ana tjetër, për shkak të rrethanave historike, do të jetë e vështirë dhe s’dua ta ngarkoj edhe më tej procesin, por në fund të procesit dëshiroj të gjejme zgjidhje për të gjitha

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 23 PRILL** - Pas konstituimit të institucioneve të reja, Kosovës i është shtuar presioni për fillimin e dialogut me Serbinë. Presidentë, kryeministra dhe diplomatë të ndryshëm, në letrat e urimit për presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti, kanë

kërkuar vazhdimin e këtij procesi. Madje presidenti amerikan Joe Biden ka bërë me dije se në këtë proces duhet të bëhen kompromise të vështira. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ende nuk e ka bërë të qartë se cila do të jetë qasja e qeverisë ndaj dialogut në përgjithësi. Ai ka deklaruar se do të jetë një qasje ndryshe ndaj këtij procesi dhe se dialogu nuk është

prioritet i qytetarëve. “Normalizimi i raporteve me Serbinë është thelbësor për Kosovën për ta realizuar potencialin e saj dhe për integrimin e plotë në institucionet euroatlantike. E di që gjatë rrugës për arritjen e këtij qëllimi kërkohet fleksibilitet dhe kompromise të vështira dhe Shtetet e Bashkuara do të jenë partneri



çështjet”, ka deklaruar Maas. Pas takimit me kryediplomatën gjermane, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi ka nevojë që të rivendoset. “Për ne ky proces ka nevojë për një reset, pra nuk është thjesht një vazhdimësi. Institucionet tona vëmendshëm do ta shqyrtojnë secilën marrëveshje që është arritur dhe secilin dokument të shqyrtuar deri më tani. Do të zhvillojmë një dialog të bazuar në parime të qarta ku Republika e Kosovës në asnjë mënyrë nuk do të hyjë në asnjë aventurë të rrezikshme, që kanë të bëjnë me ndryshim të kufijve, logjikë kjo që i takon shekullit të kaluar”, ka thënë Osmani.

Një ditë më pas diplomati gjerman ka kundërshtuar qëndrimin e Osmanit duke thënë se procesi i dialogut nuk ka nevojë për rivendosje. “Ne do të ishim të lumtur dhe të gatshëm që të marrim pjesë dhe të kontribuojmë në këtë. Dialogu tashmë ekziston dhe nuk duhet të rivendoset. Duke pasur parasysh që ky konflikt

ekziston, ju nuk duhet të filloni nga e para dhe gjithçka që ishte objekt i negociatave në të kaluarën duhet të përdoret tani, në mënyrë që të arrihen rezultate tani”, ka thënë Maas për mediat serbe.

### Kosova të përgatitet për vazhdimin e dialogut

Njohësit e rrethanave politike në vend dhe shoqëria civile kanë kërkuar nga institucionet e Kosovës të përgatiten për vazhdimin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Sipas tyre, në këtë proces duhet të synohet arritja e një konsensusi nacional mes pozitës dhe opozitës. Analisti politik Behxhet Shala ka deklaruar për “Epokën e re” se Kosova do ta ketë të vështirë ta kundërshtojë ndonjë marrëveshje ndërkombëtare në këtë proces. “Albin Kurti nuk mund t’i kundërshtojë marrëveshjet ndërkombëtare. Siç dihet, ato janë të panegociueshme për ndërkombëtarët dhe të

pakthyeshme. Tani të gjithë po e përmendin një marrëveshje me Serbinë, por gjithnjë po përmendet kompromisi. Ende nuk dihet se çfarë përmban ai kompromis. Pra, a përbën asociacionin e komunave me shumicë serbe, i cili skajshmërisht e bën Kosovën jofunksionale apo përmban ndryshimin e kufijve”, ka thënë Shala.

Sipas tij, as publikimi i dokumentit ‘non-paper’ i kryeministrit të Sllovenisë, Janez Jansha, i dorëzuar në Bruksel, nuk ka qenë i rastësishëm. “Për atë dokumentin slloven shumëkush po thotë se ka përmbajtje joserioze, por ata e lëshojnë një përmbajtje joserioze për ta testuar opinionin dhe pastaj ta prezantojnë në formën ‘merre ose lere’. Vetë fakti që Kosova është në defansivë dhe Serbia ka një avantazh të madh politik e diplomatik, tregon një paralajmërim jo të mirë për këtë proces”, ka thënë Shala. Edhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i ka bërë thirrje

kryeministrit Albin Kurti dhe presidentes Vjosa Osmani si bashkudhëheqës të politikës së jashtme, njëherësh edhe procesit të dialogut me Serbinë, që t’i kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj çështjeje. “Vazhdimi i dialogut nuk duhet ta gjejë Kosovën të papërgatitur, pa plan dhe pa qartësi rreth këtij procesi. KDI-ja kërkon nga Qeveria që në koordinim me Presidencën sa më parë ta përgatitin Strategjinë dhe Platformën Shtetërore për Dialogun me Serbinë, ku artikulojnë qartë e argumentohen mirë kërkesat e Kosovës lidhur me këtë proces. Konsolidimi i këtyre dokumenteve nuk duhet ta anashkalojë rolin mbikëqyrës të Kuvendit në këtë proces të rëndësishëm shtetëror, duke garantuar bashkërendim të institucioneve, gjithëpërfshirje, llogaridhënie dhe transparencë”, ka vlerësuar KDI. Gjithashtu, KDI ka bërë me dije se, krahas hartimit të Strategjisë dhe Platformës për Dialogun, qeveria duhet të ndërmarrë

hapa konkretë për arritjen e konsensusit të gjerë politik për dialogun, me qëllim të forcimit të pozicionit të Republikës së Kosovës në këtë proces. “Në këtë drejtim, kryeministri dhe presidentja, konform përgjegjësisë të tyre kushtetuese, duhet të iniciojnë dhe t’i kontribuojnë ndërtimit të konsensusit politik lidhur me dialogun, ndërsa subjektet opozitare duhet të jenë të përgjegjshme për arritjen e konsensusit për këtë çështje të interesit shtetëror, duke treguar përkushtim dhe konstruktivitet për tejkalimin e pengesave për arritjen e pajtueshmërisë”, është thënë në njoftimin KDI.

Zyrtarët e BE-ja kanë paralajmëruar se shumë shpejt pritet të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi.

Paraprakisht, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pritet që shumë shpejt ta vizitojë Brukselin, ku do të takohet me zyrtarët e lartë të BE-së. Të njëjtën gjë do ta bëjë edhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq.

## Sfidat e ndërmjetësimit në Kosovë

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 PRILL - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, të premtën ka mbajtur një tryezë virtuale në të cilën është prezantuar raporti “Sfidat e ndërmjetësimit në Kosovë”.

Hulumtuesja e IKD-së, Gzime Hashani, ka deklaruar se, pavarësisht që Kosova ka ndërtuar infrastrukturë të avancuar ligjore sa i përket kësaj fushe, sistemi gjyqësor dhe prokurorial ende nuk e shfrytëzojnë sa duhet këtë mënyrë të zgjidhjes së lëndëve. Ajo ka thënë se duke vepruar në këtë mënyrë, sistemi i drejtësisë, përpos që cenon të drejtat e palëve, gjykatësit dhe prokurorët ngarkojnë veten me lëndë të cilat potencialisht mund të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Hashani ka thënë se IKD-ja ka gjetur se në vitin 2017 dhe 2018 nga ana e gjykatës shumë pak raste janë referuar për ndërmjetësim, derisa ka një ngritje të theksuar në vitin 2019 dhe një regres në vitin 2020.

Më tutje, sipas Hashanit, gjatë vitit 2017 të gjitha prokuroritë e Kosovës kanë referuar në ndërmjetësim gjithsej 682 raste, derisa në vitin 2018 ky numër është ngritur në 904. Ajo ka



thënë se ky numër ishte rritur dukshëm në vitin 2019, kur prokuroritë kishin referuar në ndërmjetësim gjithsej 2 034 lëndë, ndërkaq gjatë vitit 2020, kur edhe puna e Prokurorit të Shtetit është influencuar nga gjendja e krijuar me pandeminë Covid-19, Prokurori i Shtetit ka referuar në ndërmjetësim gjithsej 1 608 lëndë.

Hashani ka pohuar se konform kërkesave të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, është themeluar edhe Oda e Ndërmjetësuesve me miratimin e statutit më 2 nëntor 2019 nga

Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve. Mirëpo, sipas saj, kjo odë kishte funksionuar në mënyrë të kundërligjshme për faktin se, krahas miratimit të statutit nga ana e Kuvendit të Përgjithshëm, ligji kërkon edhe aprovimin nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Ajo ka thënë se statuti i miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve në këtë rast nuk është aprovuar nga Ministria e Drejtësisë deri më 21 shtator 2020.

Duke vepruar në këtë mënyrë,

sipas Hashanit, IKD-ja ka gjetur se Oda e Ndërmjetësuesve e cila vepron në pajtim me ligjin dhe statutin e saj, në këtë rast ka vepruar pa bazë ligjore, pasi statuti i saj nuk ka qenë i aprovuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, rrjedhimisht nuk ka qenë në fuqi. Sipas Hashanit, IKD-ja ka gjetur se ka mungesë të të dhënave lidhur me aspektin profesional të ndërmjetësve të licencuar dhe nevojë për ngritjen e vetëdijes qytetare për zbatimin e procedurës së ndërmjetësimit.

Hulumtuesja e IKD-së, Hajrije

Krasniqi, ka thënë se në kuptim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga Ligji i ri për Ndërmjetësimin, KPK dhe KGJK kanë miratuar rregulloret për referimin e lëndëve në ndërmjetësim.

Krasniqi ka theksuar se, pavarësisht faktit se për ndërmjetësimin e detyrueshëm ekziston një dispozitë e qartë, e cila obligon gjyqtarët që këto raste t’i procedojnë në procedurë të ndërmjetësimit, IKD-ja gjen se kjo fushë e ndërmjetësimit në Kosovë nuk ka gjetur zbatimin e kërkuar.



## Më 26 prill shënohet 23-vjetori i betejës së parë frontale ndërmjet UÇK-së dhe forcave policore serbe në Balincë

MALISHEVË, 23 PRILL (ER) - Të premten është mbajtur mbledhja e Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës UÇK-së si dhe Martirëve të Luftës. Kryesuesja e këtij komiteti, Vlorë Manaj-Krasniqi, e ka drejtuar këtë mbledhje, në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e tri organizatave të luftës së UÇK-së në këtë komunë; Sinan Gegaj, Metush Kryeziu dhe Fatmir Buçaj.

Në këtë mbledhje u vendos që nën përkujdesjen e Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-së - Dega në Malishevë - të shënohet 23-vjetori i betejës apo sulmit të parë frontal të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 26 prill 1998, në Balincë të Komunës së Malishevës. Në këtë betejë morën pjesë 23 luftëtarë nga Njësi "Lumi" dhe pesë luftëtarë nga Njësi "Pëllumbi". Beteja udhëhiqej dhe ishte e organizuar nga komandantët Gani Krasniqi dhe Isni Kilaj.



## Bahtiri dhe Durmishi shikojnë nga afër projektin e shtratit të lumit Ibër



MITROVICË, 23 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga nënkryetari Faruk Mujka, kanë pritur në takim zëvendësministrin e Infrastrukturës, Hysen Durmishi. Në këtë takim Bahtiri dhe Durmishi diskutuan për zhvillimet aktuale në Komunën e Mitrovicës si dhe për gjendjen infrastrukturore në këtë komunë. "Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi për projektet infrastrukturore të realizuara në Mitrovicë nga Ministria e Infrastrukturës si dhe për mundësit për vazhdimin e projekteve me rëndësi për jetën

e qytetarëve. Gjatë këtij takimi zëvendësministri Durmishi ka theksuar se gjatë vitit 2022 kjo ministri do të lansojë grandin e katër në fushën e infrastrukturës për t'i mbështetur të gjitha komunat e Kosovës në mënyrë që komunave t'u mundësohet realizimi i projekteve të reja dhe përfundimi i projekteve të ngecura infrastrukturore", ka njoftuar Komuna e Mitrovicës. Në fund të këtij takimi kryetari Bahtiri dhe zëvendësministri Durmishi realizuan edhe një vizitë përgjatë lumit Ibër, për ta parë më afër rrjedhën e projektit në realizimin e shtratit të lumit Ibër.

## Për Ditën Ndërkombëtare të Librit hapet ekspozitë në qytetin e Podujevës

PODUJEVË, 23 PRILL (ER) - Dita Ndërkombëtare e Librit është shënuar me një ekspozitë në Bibliotekën e Qytetit, të cilën e ka hapur kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, e ku ishin të pranishëm edhe drejtoresha e Kulturës, Elhame Kutlovci, anëtarë të ekzekutivit dhe dashamirë të librit.

Në hapje të ekspozitës të organizuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Bibliotekën e Qytetit, kryetari

Bulliqi ka përgëzuar organizatorët e kësaj ngjarjeje. "Të gjithë lexuesve dhe dashamirëve të librit jua uroj Ditën Ndërkombëtare të Librit. E zgjodhëm bibliotekën si vendin e librit dhe lexuesve të saj që me këtë ekspozitë ta shënojmë

Ditën Ndërkombëtare të Librit. Si kryetar komune zotohem për krijimin edhe më të mirë të kushteve për lexuesit tanë dhe do të angazhohemi që këtë

bibliotekë ta pasurojmë me tituj të ri në mënyrë që lexuesit të ketë një fond të madh të titujve të librave", ka thënë Bulliqi, duke shtuar se përkrahja institucionale nuk do të mungojë asnjëherë.

Ndërsa drejtoresha e Kulturës, Elhame Kutlovci, ka folur për angazhimin dhe projektet e Drejtorisë së Kulturës dhe për krijimin e kushteve më të mira për lexuesit në bibliotekën e qytetit.



## 514 raste aktive me Covid në Gjilan

GJILAN, 23 PRILL (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit.

Ismajli ka njoftuar se Gjilani

aktualisht ka 514 raste aktive, derisa ka theksuar se 74 persona janë të shtrirë, 60 prej të cilëve me oksigjeneroterapi. Ai u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë masat kundër përhapjes së Covid-19.

Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të

pandemisë është si vijon: nga 19 866 mostra, 6 173 kanë rezultuar pozitivë, 5 524 janë shëruar, 134 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 514 raste janë aktive, të hospitalizuara me Covid janë 74 persona dhe 61 prej të cilëve me oksigjeneroterapi.





# Dita Ndërkombëtare e Turqve, Konjufca pret në takim përfaqësues të komunitetit turk

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare të Turqve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takime të ndara një delegacion të Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP), i prirë nga kryetari i kësaj partie dhe ministër i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, si dhe kryetarin e YTHP-së, Erkan Simitçi.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka uruar komunitetin turk për festën e tyre, duke i falënderuar për angazhimin e vazhdueshëm për kultivimin e marrëdhënieve ndëretnike, kontributin për ndërtimin dhe

fuqizimin e institucioneve shtetërore, si dhe proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Konjufca, pasi vlerësoi rolin e komunitetit turk për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit tonë dhe Turqisë, tha se Republika e Kosovës është shembull në rajon e më gjerë i garantimit dhe zbatimit të të drejtave të komuniteteve.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e komunitetit turk të Kosovës, pasi e uruan Konjufcën për detyrën e re në krye të Kuvendit të Kosovës, shprehën gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe kontributit të përbashkët drejt zhvillimit të gjithanshëm të vendit tonë.



# Do të organizohet mësimi alternativ i përshpejtuar për 441 nxënës të Kamenicës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 PRILL - E drejta për shkollim është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas nenit 47, ku secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve. Bazuar në këtë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka marrë vendim për organizimin e mësimi alternativ të përshpejtuar për 441 nxënës të Komunës së Kamenicës. Vendimi është marrë pas disa takimeve me të gjitha palët dhe

konsultimeve me ekspertë, bazuar në raportet e inspektoratit të arsimit, raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe raportit të Komisionit për shqyrtimin e problemit të krijuar me mosvijimin e mësimi nga një numër i madh i nxënësve në Komunën e Kamenicës.

Procesi mësimor do të zhvillohet në objektet shkollore më të afërta dhe në pajtim me rekomandimet e MASHTI-t, MSh-së dhe IKShPK-së.

MASHTI inkurajon komunën dhe të gjitha palët që sa më parë ta gjejnë zgjidhjen më të mirë që viti i ri shkollor 2021/2022 të fillojë me kohë dhe pa probleme.

# Haxhiu paralajmëron shkarkimin e Nehat Thaçit nga ShKK-ja

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se me të pranuar detyrën bashkë me kabinetin e saj, janë zotuar për zbatimin e ligjit dhe kthimin e dinjitetit në këtë institucion pavarësisht prej sfidave apo pengesave në të cilat hasen. Në një konferencë për media mbajtur të premten ajo ka thënë se janë identifikuar problemet dhe janë shfuqizuar disa vendime të paligjshme.

Çështja konkrete, sipas zëvendësministrit Blerim Sallahu, ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të një prone të Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë të kundërligjshme me shkelje të rënda e flagrante. "Prona e cila gjendet në Zonën



Urbane - në hyrje të qytetit të Vushtrrisë, përkatësisht në

pronën ku ka qenë i ndërtuar 'Hoteli Vicianumi'. Prona në

fjalë ka gjithsej 2 hektarë e 12 ari e 17 metra (katrorë). Në lidhje me këtë, drejtori i përgjithshëm i ShKK-së, Nehat Thaçi, ka marrë vendimin me nr. 742 për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së lartcekur personave juridiko-privatë për periudhën nga 1 deri në 15 vjet", ka thënë Sallahu.

Ai ka potencuar se kontrata që është lidhur mes drejtorit të përgjithshëm Nehat Thaçi dhe ish-ministrit Selim Selimi në njërin anë dhe kompanisë të regjistruar pas afatit në anën tjetër, përmban huqje ligjore pasi, sipas tij, baza në të cilën janë mbështetur nuk jep të drejtën e dhënies në shfrytëzim

parcelën prej 2 hektarë e 12 ari e 17 metra katrorë. "Në formë të çmimit të qerasë, ShKK përfiton çmimin absurd 2 100 euro në muaj, në lokacionin ku vetëm një ari, sipas vlerës së tregut, kushton minimalisht nga 50 deri në 100.000 euro", ka thënë Sallahu.

Ministria Haxhiu ka thënë se do t'i ndërmarrë procedurat disiplinore për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, Nehat Thaçi, gjithashtu ka ftuar Prokurorin e Shtetit për t'i hetuar dhe zbardhur veprat e dyshimta penale të shtjelluara në këtë konferencë dhe në raportin e auditorit për ta mbrojtur interesin publik të qytetarëve.




## Policia shton kontrollet për zbatim të masave kundër Covidit

**EPOKA E RE****Qendresa RAMA**

**MITROVICË, 23 PRILL** - Në zbatim të planit operativ Covid-19, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë, Jug, gjatë këtyre ditëve ka vazhduar zbatimin e masave kundër Covidit, gjithnjë në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 dhe vendimet e fundit të qeverisë. Angazhimet policore janë duke vazhduar në bashkërendim me mekanizmat e tjerë ndërinstitucional, ku i gjithë angazhimi ka reflektuar si masë parandalimi dhe ngritje e nivelit të respektimit të masave. Krahas angazhimeve në përputhje me dispozitat e

parapara ligjore, me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për respektimin e masave për mbrojtjen nga pandemia, policia ka shtuar kontrollet dhe angazhimet në: qendrat tregtare, lokalet e gastronomisë, transportin publik e, po ashtu, edhe respektimi i masës së kufizimit të lëvizjes. Policia e Kosovës vazhdon të apelojë te qytetarët për respektim të masave kundër Covidit. Zbatimi i Ligjit kundër Covidit nga policia është një detyrë sa ligjore aq edhe humane, andaj u bëjmë thirrje qytetarëve të respektohen dispozitat ligjore dhe vendimet e institucioneve të vendit në të mirë të shëndetit publik. Po ashtu, edhe Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj

gjatë këtyre ditëve ka vazhduar zbatimin e masave Covid-19, gjithnjë në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19. Për këtë periudhë në këtë komunë janë shqiptuar 344 gjopa si dhe janë dhënë 106 vërejtje policore. "Angazhimet policore janë duke vazhduar në bashkërendim edhe me mekanizmat e tjerë ndërinstitucional, inspektorët, ku i gjithë ky angazhim ka reflektuar si masë parandalimi dhe ngritje e nivelit të respektimit të këtyre masave. Policia, me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për respektimin e masave, ka shtuar kontrollet në qendrat tregtare, lokalet e gastronomisë,



transportin publik të udhëtarëve, po ashtu edhe kontrollin e respektimit të kufizimit të lëvizjes së qytetarëve pas orës 22:30-

05:00", ka njoftuar Policia e Kosovës. Kontrolle të njëjta të policisë ka pasur në të gjitha komunat e Kosovës.

## Vlerësohet bashkëpunimi i sistemit prokurorial i Kosovës me EULEX-in



**PRISHTINË, 23 PRILL (ER)** - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës (KPK), Jetish Maloku, ka pritur të premtën në takim shefin e misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Lars-Gunnar Wigemark, me të cilin ka diskutuar për aktivitetet e sistemit prokurorial për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, në këtë takim ka paraqitur aktivitetet, planet dhe angazhimet e tjera të sistemit prokurorial të Kosovës për

ngritjen e vazhdueshme të efikasitetit të këtij sistemi në periudhën e pandemisë aktuale të Covid-19. Kryesuesi Maloku ka thënë se Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes politikave të veta të mandatuara në vazhdimësi angazhohet për ngritjen e kapaciteteve profesionale të sistemit prokurorial me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit. Shefi i EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, ka theksuar se institucioni që ai drejton është i përkushtuar për ta mbështetur sistemin prokurorial të Kosovës

përmes këshillave dhe rekomandimeve për të forcuar këtë sistem. Në të njëjtin takim u diskutua se si të forcohen efektiviteti, transparencja dhe llogaridhënia e sistemit prokurorial dhe mundësia e ndihmës së EULEX-it në këtë drejtim. Në fund të takimit të dy bashkëbiseduesit vlerësuan se bashkëpunimi ndërinstitucional është shumë i rëndësishëm, andaj edhe shprehën gatishmërinë e vazhdimin dhe thellimit të bashkëpunimit.

## KOMF-i: Pandemia rëndoi gjendjen e shërbimeve sociale

**PRISHTINË, 23 PRILL** - Viti 2020 po cilësohet viti më i rëndë në 20 vjetët e fundit sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale. Kjo e gjetur është publikuar në raportin e monitorimit "Shërbimet sociale në kohë pandemie", të paraqitur nga koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë-KOMF. Në këtë raport

bëhet me dije se në vitin 2020 shërbimet sociale ishin në gjendje edhe më të rëndë krahasuar me vitin 2019, derisa u tha se pandemia ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve në nevojë për shërbime sociale. Drejtoresha ekzekutive e KOMF-it, Donjeta Kelmendi, ka thënë se gjatë vitit 2020 është rritur numri i rasteve të dhunës

në familje dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mbetur pa shërbime për shkak të masave të ndërmarra. Ajo ka thënë se krahas pandemisë, edhe gjendja e paqëndrueshme politike në vend gjatë 2020-s pati ndikim në përkeqësimin e mirëqenies sociale dhe decentralizimin e shërbimeve sociale dhe familjare.



## Në QKUK realizohet me sukses intervenimi në fushën e kirurgjisë bariatrike



**PRISHTINË, 23 PRILL (ER)** - Në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, është realizuar intervenimi me qasje laparoskopike në fushën e kirurgjisë bariatrike (ose ndryshe heqja e peshës së tepërt nga trupi).

Ky intervenim është realizuar në bashkëpunim me stafin shëndetësor të Klinikës së Anestezionit, me ç'rast pacienti i është nënshtruar operacionit "Sleeve gastrectomy - Body Mass Index" (Zvogëlim enorm i lukthit për arsye të obezitetit).

Pacientja (52-vjeçare) është liruar në shtëpi shtatë ditë pas operimit në gjendje të mirë shëndetësore. Stafi i Klinikës i Kirurgjisë Abdominale është i përkushtuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, për të cilat pacientët tanë më parë operacionet e tilla i kryenin jashtë vendit.



# Shqiptohen gjashtë gjopa ndaj bizneseve në Prizren që nuk respektojnë masat kundër Covidit

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 PRILL - Në regjionin e Prizrenit, Inspektorati Sanitar i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), bashkë me Policinë e Kosovës, kanë vazhduar aksionin dhe gjobitjen e pronarëve të lokaleve të cilët po shkelin masat kundër Covidit.

Në ekipet e përbashkëta janë shqiptuar gjopa për personat fizikë dhe juridikë që gjithsej

ishin gjashtë. Po në këtë aksion janë mbyllur lokale në afat të pacaktuar për shkak të mosrespektimit të masave kundër Covidit. "AUV në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në Regjionin e Prizrenit ka zhvilluar një kontroll për mbikëqyrje të zbatimit të masave Covid-19, sipas vendimit të fundit të qeverisë 01/07. Në të gjitha rastet ku janë hasur shkelje të pikave të vendimit, inspektorët sanitarë kanë shqiptuar gjopa për persona juridikë, ku

kryesisht kanë qenë të përfshira lokalet e gastronomisë, bare dhe restorante, si dhe lokalet e lojërave online. Në ekipet e përbashkëta janë shqiptuar gjopa për personat fizikë dhe juridikë që gjithsej ishin gjashtë. Në dy raste ku shkeljet kanë qenë më të mëdha kemi ndëshkuar me gjopa dhe i kemi mbyllur për afat të pacaktuar deri në krijim të kushteve", ka thënë zëdhënësi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Lamir Thaçi.



## Shefi i BE-së: Vendim i duhur publikimi i listës së bizneseve që përfituan më së shumti



PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, e ka quajtur vendim të duhur publikimin e listës së bizneseve që kanë përfituar më së shumti nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Szunyog përmes një postimi në "Twitter" ka thënë se e mbështet vendimin e ministrit të Financave, Hekuran Murati, i cili bëri publike këtë listë. Ai e ka quajtur këtë hap pozitiv drejt transparencës dhe llogaridhënies. "Mbështes vendimin e Hekuran Muratit

për publikimin e listës me 50 përfituesit më të mëdhenj të fondeve publike të Kosovës. Një hap pozitiv drejt transparencës dhe llogaridhënies. Ky është një kusht me të cilin BE-ja u pajtua me Kosovën kur u nënshkrua marrëveshja e huas për ndihmë makro financiare prej 100 milionë eurosh", ka shkruar Szunyog.

Shefi i BE-së më tej ka thënë se masat ndihmëse duhet t'i kenë në fokus audienat e duhura, të jenë të mirëdizajnuara dhe të jenë transparente.

## Ministrja e Ekonomisë e pret në takim ambasadorën e Maqedonisë së Veriut

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, është takuar të premtën me ambasadorën e Maqedonisë së Veriut në Kosovë, Shpresa Jusufi, e cila ka uruar ministren Rizvanolli për emërimin në krye të Ministrisë së Ekonomisë. Të dyja palët u shprehën të kënaqura me raportet miqësore mes dy vendeve fqinje dhe u shprehën të gatshme për thellimin e

këtyre marrëdhënieve dhe bashkëpunimit institucional mes dy shteteve. Ndër të tjera, diskutuan për çështjet ekonomike të dy vendeve, për sfidat e trashëguara dhe për hapësirat e mëtutjeshme për iniciativat e përbashkëta në sektorë strategjikë, me ndikim të lartë për ekonominë e dy vendeve në të ardhmen të cilat janë të mirësearchura për rajonin tonë.



## ANP "Adem Jashari" thyen rekord me numrin e pasagjerëve

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ishte më i ngarkuari me pasagjerë në mesin e aeroporteve të shteteve të ish-Jugosllavisë gjatë tremujorit të parë të vitit

2021, duke arritur shifër rekorde. Në mars shifrat u rritën në 23.3 për qind në krahasim me vitin 2020. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" pati 330 787 pasagjerë gjatë periudhës janar - mars,

krahasuar me rreth 283 000 në Aeroportin e Beogradit i cili pozicionohet në vendin e dytë dhe në vendin e tretë renditet aeroporti i Shkupit me 148 991 udhëtarët gjatë kësaj periudhe.





**EURO GLASS**  
 eg  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
 'BUJQËSIA'  
 TEL: 045/82 82 82**

# Peja dhe Ylli kualifikohen në gjysmëfinale

Prishtinë, 23 prill - Peja është kualifikuar në gjysmëfinale të "Play-off"-it të FIVE STAR Superligës, pasi fitoi ndeshjen e tretë çerekfinale (2:1) ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 100:83 (25:19, 25:25, 25:23, 25:16). Skuadra pejane e nisi ndeshjen më mirë, duke pasur 10 pikë epërsi në çerekun e parë (25:15), që përfundoi 25:17. Perioda e dytë ishte tërësisht e barabartë, çka e dëshmon edhe rezultati 25:25, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 50:44. Vendasit ishin në epërsi konstante edhe në periodën e tretë, ku përkundër tentimeve nga prishtinasit, kjo pjesë përfundoi 25:23, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 75:67. Në 10 minutat e fundit, Peja menaxhoi lojën dhe epërsinë e krijuar, duke e thelluar edhe më shumë, për të triumfuar 100:83, çka i mjaftoi për të kaluar në gjysmëfinale, ku i pret Ponte Prizreni. Gjysmëfinalja e parë zhvillohet të dielën në Prizren, ndërsa skuadra që shënon tri fitore kualifikohet në finale. Te Peja u dalluan Brandon Walters me 33 pikë e 16 kërcime, Lis Shoshi me 18 pikë e 10 kërcime dhe Aj Walton me 19 pikë e 8 asistime, ndërsa te Sigal Prishtina u dalluan Nigel Johnson me 26



pikë dhe Tevin Mack me 25. Golden Eagle Ylli ka kaluar në gjysmëfinale të "Play-off"-it në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll, pasi në ndeshjen e tretë çerekfinale mundi Bashkimin 97:79 (32:21, 28:17, 27:24, 10:17). Ylli në gjysmëfinale do të përballet me Rahovecin, derisa skuadra që shënon tri fitore do të kualifikohet në finale

e madhe. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi konstante në çerekun e parë, që përfundoi 32:21. Dallimi i madh u bë në periodën e dytë, ku therandasit ishin shumë më të mirë, duke e fituar këtë pjesë 28:17, për të shkuar në pushim me shifrat 60:38. Epërsinë e madhe të krijuar në pjesën e parë e ruajtën edhe në pjesën e

dytë, për të triumfuar në fund me rezultat 97:79. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Elyjah Clark me 36 pikë, Lg Gill me 16 dhe Erjon Kastrati me 15, kurse te Bashkimi më të mirët ishin Obinne Oleka me 24 pikë e 13 kërcime, Milos Latković me 19 pikë e shtatë kërcime dhe Christian Lutete me 15 pikë e gjashtë kërcime.

## Kosova zhvillon dy miqësore në qershor

Prishtinë, 23 prill - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) nëpërmjet një njoftimi për media ka njoftuar se Përfaqësuesja e Kosovës do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore në muajin qershor. "Dardanët" zhvillojnë miqësore me San Marinon më 1 qershor dhe më 4 qershor ndaj Kazakistanit. "Përfaqësuesja e Kosovës do t'i luajë dy ndeshje miqësore në terminin e lirë të UEFA-s FIFA-s në fillim të muajit qershor. Fillimisht më 1 qershor, 'dardanët' do të luajnë kundër San Marinos, në orën 18:00 në stadiumin 'Fadil Vokrri', derisa më 4 qershor në të njëjtën kohë dhe vend do të zhvillohet miqësorja tjetër me Kazakistanin", thuhet në njoftimin e FFK-së.



## Sot dy ndeshje në Superligë, nesër Drita - Prishtina

Prishtinë, 23 prill - Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshjet e para të Superligës së Kosovës në futboll. Arbëria e pret skuadrën e Besës dhe pret nga kjo ndeshje tri pikët e plota në mënyrë që ta vazhdojë garën për mbijetesë. Në anën tjetër Besa tashme ka rënë edhe matematikisht nga elita. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Drenicës dhe Feronikelit. Të dy klubet do të kërkojnë pikë nga kjo ndeshje, pasi asnjëra nuk e ka të

siguruar tash për tash mbijetesën. Të dielën zhvillohen tri ndeshjet e tjera ku spikat derbi në mes të Dritës dhe Prishtinës. Skuadrat që po luftojnë për titull do të përpiqen të 'iarrin pikët maksimale në mënyrë që ta kenë më të lehtë rrugëtimin drejt objektivit të titullit. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Suharekë në mes të Ballkanit dhe Gjilanit. Kjo është ndeshja e parë për trajnerin Ismet Munishi ndaj

ish-klubit të tij. Ndeshja e tretë dhe e fundit që zhvillohet të dielën është ajo në mes të Llapit dhe Trepçës '89.

**SUPERLIGA - JAVA 30**

Të shtunën takohen:  
 15:00 Arbëria - Besa  
 15:00 Drenica - Feronikeli

Të dielën takohen:  
 15:00 Drita - Prishtina  
 15:00 Ballkani - Gjilani  
 15:00 Llapi - Trepça '89



## Ademi: Do të ftojme lojtarë nga Shqipëria

Prishtinë, 23 prill - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, për ATV, ka deklaruar që në të ardhmen Kosovës mund t'i bashkohen edhe lojtarët nga Shqipëria. I pari i FFK-së ka

thënë që edhe Kosova do të shikojë mundësinë që të afrojë lojtarë nga Shqipëria. "Çdo moment që neve që na duhet ose na konvenon për ekipin kombëtar, ne do të marrim lojtarë, këtu

nuk bën përjashtim as Shqipëria. Në kombëtare do të afrohen vetëm lojtarët më të mirë", ka thënë Ademi. Deri më tash te Kosova janë ftuar futbollistë edhe nga trojet e tjera shqiptare.





## Klubet që u tërhoqën nga Superliga duhet të paguajnë nga 300 milionë euro

MADRID, 23 PRILL - Superliga Evropiane duket se do të prodhojë ende çështje për të diskutuar. "Vozpopuli" bën me dije se klubet e larguara nga projekti do të përballen me një gjobë të majme. Siç bëhet me

dije, të gjitha klubet që kanë vendosur të largohen do të duhet të paguajnë 300 milionë euro për kokë për braktisjen e projektit madhor, një gjobë që do t'i dërgonte klubet pjesëmarrëse në krizë totale.

Në kontratë është parashikuar se kjo shumë do të paguhet në harkun e disa viteve me këste. 10 klubet e tërhequra nga Superliga ende nuk e kanë bërë zyrtarisht këtë gjë, të vetëdijshëm për gjobën e

madhe. Deri më tani vetëm Barcelona e Real Madridi nuk e kanë lënë Superligën, me Juventusin që e ka bërë një deklaratë, por Agnelli duket ende këmbëngulës për krijimin e një turneu të tillë.



## Fetahu takohet me ministrin Çeku, premtohet thellimi i bashkëpunimit

PRISHTINË, 23 PRILL - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme Elvira Dushku janë pritur nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Hajrulla Çeku dhe u. d. sekretari i përgjithshëm i MKRS-së, Ibër Alaj. Kryetari Fetahu e ka njoftuar ministrin Çeku për aktivitetet e FBK-së për vitin 2021 si dhe për miratimin e Planit Strategjik të FBK-së për vitet 2021-2025, së fundi edhe nga Kuvendi i Punës i Federatës së Basketbollit të Kosovës. I pari i basketbollit të Kosovës e ka njoftuar ministrin Çeku edhe me ecurinë e projektit të Ligës Unike, Final 8 të organizuar, si dhe garat që pritet të fillojnë në kuadër të kësaj lige në formë të edicionit të rregullt që nga shtatori i këtij viti. Numri një i FBK-së ka kërkuar nga MKRS mbështetje për implementimin e këtij projekti mbarëkombëtar, i cili, krahas garës seniore në konkurrencën e meshkujve, pritet të fillojë edhe atë



në konkurrencën e femrave dhe në garat e të rinjve, si dhe me bashkëpunime në nivele të ndryshme me dy shtetet. Në anën tjetër, ministri Çeku e ka përgëzuar kryetarin Fetahu dhe FBK-në për të arriturat e deritashme, duke u dëshiruar suksese në vazhdim, si dhe ka premtuar se MKRS do të vazhdojë ta mbështesë FBK-në për

implementimin e aktiviteteve vendore e ndërkombëtare. Kryetari Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme Dushku e falënderuan ministrin Çeku për kohën e ndarë dhe në të njëjtën kohë premtuan se së bashku me gjithë komunitetin e basketbollit do të vazhdojnë të punojnë për avancimin e sportit të Kosovës në përgjithësi.

## Dallasi mposht lakersat, fitojnë Bucksit e Celticsit

TEXAS, 23 PRILL - Moment me shumë ulje-ngritje për Los Angeles Lakersin në NBA. Kalifornianët pësuan humbjen e tretë në katër ndeshjet e fundit dhe të 24-n në këtë sezon pasi u mposhtën me rezultatin 115-110 nga Dallas Mavericksit në Texas. Në "American Airlines Center" Luka Doniq shfaqti pjesë nga repertori i tij më i mirë dhe me 30 pikë, 9 rebounde e 8 asistime udhëhoqi Mavericksin drejt suksesit numër 32 në këtë sezon. Rikthimi i Antony Davisit nga dëmtimi i gjatë në tendinën e Akilit nuk ishte i mjaftueshëm për LA Lakersin pasi ylli i kalifornianëve në 16 minuta lojë shënoi vetëm katër pikë, ndërkohë që më i miri mbi parket për skuadrën e Frank Vogel ishte Caldwell-Pope me 29 pikë. Milwaukee Bucks u rikthye te fitorja pas dy humbesh rresht duke mposhtur Philadelphia 76ers me rezultatin 124-117. Humbja e



tretë radhazi për skuadrën nga Pensylvannia që tashmë rrezikon vendin e parë në Lindje të cilin për momentin e ndan me Brooklyn Netsin. Kjo sfidë mori drejtim që në pjesën e parë me Milwaukeeen që shkoi në pushim në avantazhin e 17 pikëve dhe më pas menaxhoi e qetë ndeshjen. Giannis Antetokounmpo me 27 pikë dhe Chris Middleton me 24 pikë ishin dy basketbollistët që udhëhoqën Bucksin drejt këtij suksesi, ndërkohë që te miqtë spikati

kamerunasi Joel Embiid me 24 pikë, raporton "Supersport". Moment i shkëlqyer për Boston Celticsin që mori fitoren e 7 në 8 ndeshjet e fundit pasi kaloi me rezultatin 99-86 Phoenix Suns në "TD Garden". Kemba Walker me 32 pikë ishte heroi i padiskutueshëm i Bostonit në këtë sfidë, ndërkohë që te Phoenix Suns spikati Chris Paul me 22 pikë, 8 rikuperime poshtë tabelës dhe 8 pasime vendimtare. Me këtë fitore Celticsit u ngjiti në vendin e 5-të të Konferencës së Lindjes, ndërkohë që Phoenixi, pavarësisht prej humbjes, nuk e rrezikon vendin e dytë në Perëndim. Një fitore të thjeshtë mori San Antonio Spursi që mposhti 106-91 Detroit Pistonsin në "AT&T Center", një sukses që e katapultoi skuadrën e Gregg Popovich në vendin e 9-të të Konferencës së Perëndimit me San Antonion që me shumë gjasë do të jetë në "play-off".

### SHKURT

#### Mazepin: Mick Schumacher ka disa privilegje që unë nuk i kam

Sezoni 2021 nuk ka nisur ashtu si duhet për pilotin e ri rus Nikita Mazepin që garon me makinën amerikane Haas. Në garën e parë ai u tërhoq pas një aksidenti, ndërsa në garën e dytë u klasifikua i 17-ti, pas shokut të skuadrës, Mick Schumacher. Të dy pilotët e Haas debutojnë këtë sezon në Formula 1, por pista ka treguar deri më tani se i riu gjerman është më superior se shoku i tij i skuadrës. "Të gjithë shohin Formula 1 dhe nëse bëj një hap fals, pasojat janë të mëdha. Ky është një sport i vështirë dhe kur vendos kokoren nuk ka shumë kohë për të menduar për diçka tjetër. Në garën e Portimao do të jetë e vështirë për mua, pasi te Haas nuk kemi një simulator të pistës", ka thënë Mazepin. "Me shumë gjasa, Mick do të ketë mundësinë të përdorë një simulator të pistës që ka Ferrari, por duke qenë se nuk jam anëtar i asnjë akademie, nuk do ta kem këtë privilegj. Kjo do të thotë që për garën e radhës do të përgatitem në Moskë", ka shtuar Mazepin.

#### Këta katër futbollistë synohen nga Unitedi

Skuadra e Manchester Unitedit pritet të bëjë përf forcime të mëdha në afatin kalimtar veror në mënyrë që edicionin tjetër të garojë për titull në Premierë Ligë. Në listën e trajnerit Ole Gunnar Solskjaer janë katër futbollistë. Mbrojtësi i Real Madridit, Raphael Varane, i prinë listës. Mbrojtësi francez kushton rreth 60 milionë euro. Futbollisti tjetër është Declan Rice për të cilin West Ham Unitedi kërkon 60 milionë euro. Në listë është edhe ylli i Borussia Dortmundit, Jadon Sancho, që kushton 80 milionë euro dhe sulmuesi i Frankfurtit, Andre Silva, që kushton 40 milionë euro.

#### Ibra vazhdon kontratën me Milanin

AC Milan ka arritur akordin final për rinovimin e kontratës me sulmuesin Zlatan Ibrahimović. Lajmin zyrtar e bën të ditur vetë klubi milanez përmes një deklaratë për mediat, ku njofton se suedezi ka vazhduar kontratën e tij deri në vetën e vitit 2022. "AC Milan njofton se ka rinovuar kontratën e Zlatan Ibrahimoviçit. AC Milan është skuadra italiane me të cilën Zlatan ka zhvilluar më shumë ndeshje me 84 gola të shënuara në 130 ndeshje të luajtura në karrierën e tij me AC Milan. Kampioni suedez do ta veshë fanellën e kuqezinjve përsëri sezonin e ardhshëm", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi.

#### Varane në shitje

Real Madridi po dëshiron që ta shesë mbrojtësin e vet, Raphael Varanen, sipas raportimeve nga AS. Klubi është i etur që ta transferojë David Alabanë i cili do të jetë agjent i lirë këtë verë dhe spekulimet e kanë lidhur tash e një kohë me mbretërit. Ata, po ashtu, po provojnë që ta bindin kapitenin e tyre, Sergio Ramosin, që ta pranojë uljen e pagës për 10 për qind në mënyrë që ta arrijnë një marrëveshje të re. Mirëpo, francezin nuk po e shohin më aset, pasi po planifikojnë ta largojnë nga "Santiago Bernabeu".

## Gjiganti amerikan tërhiqet nga sponsorizimi i Superligës Evropiane

"Ne pa dyshim kemi gjykuar keq ndikimin që kjo marrëveshje mund të kishte në të gjithë komunitetin e futbollit në të ardhmen. Ne do të mësojmë nga kjo". Kjo gjë u raportua nga Tariq Panja, reporter i "New York Times", dhe është përcjellë nga

"L'Equipe" e gazetat spanjolle. Ky është pozicioni i "JP Morgan" mbi Superligën, i bërë publik nga një zëdhënës i bankës së njohur në ShBA, që ishte sponsori kryesor i kompeticionit të ri, themeluar nga 12 klube, por i zhbërë brenda 48 orëve.

"JP Morgan" ishte financuesi kryesor i projektit, me një disbursim të madh parash, parashikuar në 3.5 miliardë euro për 12 klubet themeluese të turneut të ri. Sipas "Financial Times", do të kishte qenë një hua afatgjatë për 23 vjet, me një normë interesi prej 2-3

%. Në ditët e fundit, megjithatë, "Standard Ethics", një agjenci e pavarur vlerësimi për qëndrueshmërinë, kishte ulur vlerësimin e korporatave të "JP Morgan" në "E+" nga "EE-" të mëparshme.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.  
Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)

Në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve, Ndërmarrja Publike Lokale PALLATI I RINISË SH.A., **shpallë:**

#### FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE

Ftoheni që të ofertoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve afariste, zyre dhe depot të cilat janë pronë e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Pronat e evidentuara me poshtë u jepen me qira personave juridik.

#### Hapësirat afariste të cilat jepen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m <sup>2</sup> (pa TVSH)	Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m <sup>2</sup> (pa TVSH)
1.	Lokali nr. 52	42 m <sup>2</sup>	12.00 €	8.	Depo nr.02	54 m <sup>2</sup>	6.17€
2.	Lokali nr. 58	20 m <sup>2</sup>	12.00 €	9.	Depo nr.04	70 m <sup>2</sup>	6.17€
3.	Lokali nr. 59	18 m <sup>2</sup>	12.00 €	10.	Depo nr.05	60 m <sup>2</sup>	6.17€
4.	Lokali nr. 61	58 m <sup>2</sup>	12.00 €	11.	Depo nr.06	70 m <sup>2</sup>	6.17€
5.	Lokali nr. 62	20 m <sup>2</sup>	12.00 €	12.	Depo nr.07	70 m <sup>2</sup>	6.17€
6.	Lokali nr. 98	9 m <sup>2</sup>	21.00 €	13.	Depo nr.08	60 m <sup>2</sup>	6.17€
7.				14.	ZYRE nr. 114	45 m <sup>2</sup>	5.00€
8.				15.	ZYRE nr. 116	39 m <sup>2</sup>	5.00€

#### Kushtet e Përgjithshme

- Periudha e qiradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
- Qiramarrësi me anë të nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një qiraje mujore në logarit të Qiradhënësit.
- Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.
- Përveç çmimit fillestar, qiramarrësi do të paguaj plus shpenzimet tjera të parashikuara me kontratë (rrymë, pastrim, nxeheje, ujë, kanalizim).
- Këto lokale nuk janë të destinuar për hotelieri.

#### Kriter për përzgjedhjen e ofertuesit me të favorshëm është:

- Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
- Marrja me qira e krejt lokaleve.
- Tarifa e aplikimit është 200.00 €, ku ofertuesit të zgjedhur, tarifa e aplikimit do ti kompensohet me faturën e parë të qirasë, ndërsa ofertuesit të zgjedhur i cili tërhiqet nga Kontrata për qira, nuk i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 € dhe ofertuesit të pazgjedhur i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, e cila do të paguhet në këtë Kont: 1708020600000056.

#### Ofertuesi duhet t'i dorëzoj këto dokumente:

- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje)
- Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit; (kopje)
- Çmimin e ofertuar për m<sup>2</sup> i cili duhet të jetë pa TVSH ( Ofertë)
- Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmojë se biznesi është aktiv;
- Fletëpagesën për aplikim.

#### Ofertat nuk do të merren parasyh nëse:

- Ofertuesi i cili ka pasur lokal me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
- Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
- Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridik të cilët duan t'i vizitojnë lokalët, zyrat si dhe depot e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: **24.04.2021**, deri me datën: **30.04.2021** nga ora 10<sup>00</sup> deri në ora 15<sup>00</sup>.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: **01.05.2021** nga ora 10<sup>00</sup> deri në orën 12<sup>00</sup>, në zyrën e arhivës së qiradhënësit N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depos dhe kontaktet, si: email-i zyrtar, dhe/apo nr. i telefonit .

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit, me datë: **01.05.2021** nga ora:12:30, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë.

Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkojë përmes email-it: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com) dhe në formë fizike në zyrën nr. 17, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": <http://www.pallatirinise.com/>.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 22.04.2021 bënë shpallje publike:

#### NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS: T-21-001 - Rishpallje

Loti 7. Me kontratë shpërblehet Vllëzrit Kaqandolli, me ofertë 177,00€ me TVSH. (duhet ti sjell dokumentet shtese brenda 7 dite)

Loti 11. Me kontratë shpërblehet Burimi shpk, me ofertë 476.90 € me TVSH (dhe ujin industrial).

Loti 19. Me kontratë shpërblehet Ardi shpk Mitrovicë, me ofertë 569.70 € me TVSH.

Loti 26. Me kontratë shpërblehet G-Plus, me ofertë 1954.08 € me TVSH.

Loti 30. Me kontratë shpërblehet Doni shpk Mitrovicë, me ofertë 875.56 € me TVSH.

Loti 31. Me kontratë shpërblehet Fat-Ari Mitrovicë, me ofertë 424.80 € me TVSH.

**NJOFTIM PËR ANULIM DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRAVE NË MUNGESË TE OFERTAVE TE PËRGJEGJSIIME: LOT 8,12,13,14,16,17,22,24,25,27,33,34**

#### NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS: T-21-002

Me kontratë shpërblehet FC Hajvali, Prishtinë, me ofertë 401.20€ me TVSH.

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepccorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepccorporation.com</i>		

*Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021.*



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.  
Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)

Na osnovu odluke Borda, Lokalno Javnog Produzeca PALLATI I RINISË A.D, **Objavljuje:**

#### POZIV ZA PONUDU ZA IZDAVANJE POD KIRIJOM POSLOVNOG PROSTORA

Pozivate se da ponudi te za uzimanje na koriscenje pod kirijom poslovnog prostora , kancelarije i magacine koje su vlasnistvo L.J.P. "PALLATI I RINISE "A.d. Dole navedeno vlasnistvo se izdaje pod kirijom pravnim licima.

Poslovni prostor:

Br.	Adresa	Povrsina	Osnovna cena po m <sup>2</sup> (bez PDV)	Br.	Adresa	Povrsina	Osnovna cena po m <sup>2</sup> (bez PDV)
1.	Lokal br. 52	42 m <sup>2</sup>	12.00 €	10.	Depo br.02	54 m <sup>2</sup>	6.17€
2.	Lokal br. 58	20 m <sup>2</sup>	12.00 €	11.	Depo br.04	70 m <sup>2</sup>	6.17€
3.	Lokal br. 59	18 m <sup>2</sup>	12.00 €	12.	Depo br.05	60 m <sup>2</sup>	6.17€
4.	Lokal br. 61	58 m <sup>2</sup>	12.00 €	13.	Depo br.06	70 m <sup>2</sup>	6.17€
5.	Lokal br. 62	20 m <sup>2</sup>	12.00 €	14.	Depo br.07	70 m <sup>2</sup>	6.17€
6.	Lokal br. 98	9 m <sup>2</sup>	21.00 €	15.	Depo br.08	60 m <sup>2</sup>	6.17€
7.				16.	Kanc. br. 114	45 m <sup>2</sup>	5.00€
8.				17.	Kanc. br. 116	39 m <sup>2</sup>	5.00€

#### Opsti uslovi

- Rok ugovora je godinu dana sa mogucnoscu ponovnog produzenja,
- uzimaoc lokala je duzan da uplati jednu kiriju- ratu po potpisivanju ugovora
- Uzimaoc lokala je duzan da osigurava svoje imovinu ,material,kod osiguravajuci drustva,
- Uzimaoc lokala je duzan da pored osnovne cene lokala da uplati dodatne troskove kao sto je propisano u ugovorom kao sto je {struja,cistocu,grejanje, vodovod I kanalizaciju}.
- Ovi prostori nisu namijenjani za ugostiteljstvo.

#### POVOLNI USLOVI ZA DOBIJANJE LOKALA

- Najveca cena od onovne cene.
- Iznajmljivanje svih prostora
- Naknada za prijavu trebala bi iznositi 200,00 €, gdje će odabrani ponuditelj naknadu za nadoknadu nadoknaditi prvim računom za najam, dok je odabrani ponuditelj koja se odustaje od Ugovora o zakupu, naknada za prijavu u iznosu od 200,00 € neće se vratiti, a prijava od 200,00 € vraća se neuspješnom ponuditelju, što će se uplatiti na ovaj račun: 1708020600000056.

#### Ponudilac treba da predaje ova dokumenta:

- Uverenje o registraciji bisnisa I fiskalni broj –Fotokopje
- Dokumenat za identifikaciju lica –Fotokopje
- Cena za ponudu po m<sup>2</sup>,koja treba da bude bez PDV.
- Potvrda od UPK koje svedoci da je aktivan bisnis,
- Uplatni list za aplikaciju.

#### Ponuda nece se uzimati u obzir u koliko:

- Ponudilac koji imao ili ima local u ovo produzece a nije izvrsio svoje obaveze propisane ugovorom,
- U koliko ponuda ne poseduje kompletnu dokumentaciju,
- Ako se ne dostavi ponuda na odrjdenom roku propisano u uslovima obavestenja.

Lice koja zeli da posecuje gore navedeni poslovni prostor, mogu da posecuje od datuma: **24.04.2021 do 30.04.2021**. Od: **10<sup>00</sup> do 15<sup>00</sup>**.

Ponuda treba da se preda u zatvorena u koverti datumom: **01.05.2021 od 10<sup>00</sup> do 12<sup>00</sup>**, u Arhivi Produzeca L.J.P "PALLATI I RINISE" A.d. Na spoljnoj strani koverta treba da bude upisano: lme i Prezime ponudioca br.lokala ili kancelarije ,email adresa ili br.telefona. Ponude bice otvorene od strane komisije datumom: **01.05.2021 od 12:30**, javno pred licima ponudioca,u kancelarija uprave produzeca.

Zahtev ( aplikacija ) mozete pronaci na ( emal adresu ): [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com), ili licno mozete podici u kancelariji br.17, ili preuzeti sa zvanicnog sajta "Pallati i Rinise" : <http://www.pallatirinise.com/>.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " VED-FARM",Sh.p.k. Brestovik në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fermën e pulave në Brestovik, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.05.2021 në ora 12:00 në restorant " ANTIKA " i cili ndodhet fshatin Brestovik, Komuna Pejë në anën e majtë të Rrugës Pejë – Rozhajë do të organizohet debat publik nga Kompania " VED-FARM",Sh.p.k. Brestovik, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fermën e pulave në Brestovik, Pejë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1O HhxdmNpUWJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " VED-FARM",Sh.p.k. Brestovik për fermën e pulave në Brestovik, Pejë.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publikimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.





NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
SPORT MARKETING PRISHTINË

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, NPL "Sport Marketing" shpall:

## KONKURS

### PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

**Titulli i pozitës:** Kordinator/e për manifestime sportive

**Nr. i referencës:** NPL/KES

**Orët e Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Vendi i punës:** Rr. Sylejman Vokshi, nr. 5/A, 10000, kati i parë 10000 Prishtinë, Kosovë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- merr pjesë në përgatitjen, organizimin dhe realizimin e garave sportive dhe manifestimeve rekreative në ambientet sportive të NPL-së;
- vepron në formimin dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit, motivimit dhe planifikimit të buxhetit në fushën e kulturës fizike dhe sportit;
- merret me promovimin dhe marketingun e stileve të jetesës së shëndetshme;
- koordinon punën e klubeve sportive dhe shoqatave;
- ofron ndihmë profesionale në hartimin e akteve normative dhe planeve financiare të klubeve sportive dhe shoqatave;
- bashkëpunon me kompani të ndryshme për organizimin e rekreacionit të punonjësve,
- kujdeset për mirëmbajtjen e mjeteve themelore dhe inventarit (aseteve);
- harton projekte me rëndësi për sportin dhe edukimin fizik me qëllim të gjetjes së burimeve alternative të financimit;
- bashkëpunon me Ministrinë kompetente dhe strukturat e tjera qeveritare të cilat merren me sport dhe kulturë fizike;
- merr pjesë aktive në ndarjen e termineve të përdorimit të pishinës, tereneve dhe objekteve tjera të cilat i shfrytëzon NPL;
- kryen edhe detyra të tjera sipas urdhërit të Menaxherit.

**Përgjegjësia:** Përgjigjet për punën e tij/saj: Menaxherit të Departamentit.

#### Kushtet e veçanta:

- njohuri për të punuar në kompjuter;
- njohuri e gjuhës angleze.

Numri i ekzekutuesve: 1.

#### Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

I përgjigjet për punën e tij/saj: Sekretarit dhe Kryeshefit ekzekutiv.

Përgatitja shkollore: PMSH (përgatitje e mesme shkollore)

Përvoja e punës: 1 vit në punë administrative.

#### Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar.
- CV e aplikantit.
- Dëshminë e kualifikimit shkollor.
- Dëshminë mbi përvojën e punës, referencat si dhe certifikata tjera profesionale.
- Certifikatën nga Gjykata që nuk jeni nën hetim (Valide).
- Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Letër Motivuese për pozitën të cilën aplikoni.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqet zyrtare të NPL "Sport Marketing", si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **23.04.2021 deri me datë 07.05.2021** si datë e mbylljes së konkursit. Aplikantët e interesuar kërkesën për aplikim me dokumentacion të rregullt, duhet ta paraqesin në zyrat e **NPL SPORT MARKETING SH.A.** Rr. Sylejman Vokshi, nr. 5/A, 10000, kati i parë 10000 Prishtinë, Kosovë. Email: [info@nplsportmarketing.com](mailto:info@nplsportmarketing.com) në Prishtinë, çdo ditë pune prej orës 8:00 – 16:00. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes numrit të telefonit: 038 704-799.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letër Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejta](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejta)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Albanika" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80657471. Delvina Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.
- ▶ Serdar Spahi shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ "R Architects " ShPK shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 71214273 Prizren.
- ▶ Besnik Hashani shpall të pavlefshme katër dëftesat, certifikatën si dhe diplomën e shkollës së mesme "Koxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.
- ▶ N.N Besi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 71067157
- ▶ Gëzim Jashari shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Andon z . Çajupi"
- ▶ Kujtim Zeneli shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesën e SHMLM " Dr Xheladin Deda".
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







Hysen Beqa lindi në Molliq të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë pikëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijojnë shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

*Albin Mehmeti*

5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli  
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!


Unë jam gruaja më e fortë në botë!



6.99€



# UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli